



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 1954 Dt. 23 / 09 / 2024

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 pika 1.1.2., të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e XVIII të mbajtur më datë 20.9.2024, mori këtë:

**VENDIM**

Dr.Sc. Lindita Loku zgjidhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndët: Informatika sociale. Arkivimi digjital dhe sistemet e informimit, Programet aplikative në e-qeverisje. Programimi dhe e – Qeverisja, Databaza për e – qeverisje dhe Zhvillimet në cloud në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Zgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 168, 169 dhe 172 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328 të datës 26.06.2024.

E përmendura është e obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurës i takon paga në pajtim me Ligjin për pagat në sektorin publik Ligji Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

**Arsyetim**

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan ka shpallur konkurs Ref.nr.01/1559 të dt.29.07.2024, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik një mësimdhënës në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike për lëndët: Informatika sociale. Arkivimi digjital dhe sistemet e informimit, Programet aplikative në e-qeverisje, Programimi dhe e – Qeverisja, Databaza për e – qeverisje dhe Zhvillimet në cloud.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Dr.Sc. Lindita Loku, i plotëson kushtet për t'u zgjedh në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët e sipërpërmendura. Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve sipas raportit Ref.nr. 05/1921 të datës 20.09.2024, vendosi që Dr. Sc. Lindita Loku të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtrës të Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurës
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave



Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor  
Kryesues i Senatit